

VENDIM
Nr. 299, datë 28.5.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 418, DATË 7.7.2023, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR
PËRZGJEDHJEN E PËRDORUESIT NË PARQET TEKNOLOGJIKE DHE
SHKENCORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 5, të kreut I, të vendimit nr. 418, datë 7.7.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e përdoruesit në parqet teknologjike dhe shkencore”, shfuqizohen.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku